

Fleta e Planit Parapërgatitor për Epidemitë

Plani i Drejtorisë Arsimore Peel fokusohet në ruajtjen e shëndetit të nxënësve dhe mësuesve.

Çfarë është epidemia?

Një epidemi është çfardollos sëmundje infektive që përhapet me shpejtësi. Një formë e tillë mund të jetë gripi – epidemia gripale është një sëmundje e re virale e rrugëve të frymëmarrjes që zhvillohet kur një goditje e re e virusit të gripit shfaqet dhe shpërndahet me shpejtësi. Njerzit do të kenë pak ose aspak imunitet ndaj këtij virusi të ri.

Kur do të ndodhë epidemia?

Expertët nuk mund të parashikojnë se kur mund të ndodhë epidemia e ardhëshme, por historikisht ato kanë ndodhur tre ose katër herë në çdo qindvjeçar. Organizata Botërore e Shëndetit dhe autoritetet shëndetësore të sistemit federal, provincës dhe ato lokale, kanë filluar përgatitjen e planeve epidemiologjike.

Sa njerëz do të preken?

Expertët thonë se 40% deri 60% do të lenë punën në një moment të caktuar të epidemisë. Mungesa të konsiderueshme, mund të çojnë në anulimin e shërbimeve që sigurohen nëpërmjet Drejtorisë Arsimore Peel.

Cili është Plani Epidemiologjik i Drejtorisë Arsimore Peel?

Drejtorja Arsimore Peel është e mirë-përgatitur për epidemitë. Gjatë vitit shkollor 2005-06, drejtorja ndërtoi një plan epidemiologjik përgatitor për shkollat dhe vendet e punës së tij. Për ndërtimin e këtij plani, bordi punoi ngushtësisht me Seksionin e Shëndetit të Peel dhe me ministritë e shëndetit e arsimit, si dhe me stafin e vet dhe sindikatat.

Në rast të një epidemie të konfirmuar në Ontario, Drejtorja Arsimore Peel do të aktivizojë planin e vet epidemiologjik. Gjatë një epidemie Drejtorja Arsimore do të ndjekë këshillat dhe udhëzimet e zyrtarëve lokalë dhe të provincës për shëndetin publik, të cilët kanë gjithë aftësitë profesionale, të përcaktojnë nivelin e rizikut shëndetësor, që paraqet një situatë e caktuar.

Përparësia jonë gjatë një epidemie është t'i mbajmë shkollat të hapura dhe për aq kohë sa është nuk është e dëmshme, me përjashtim të raseve kur udhëzohet ndryshe nga autoritetet publike shëndetësore të Ontarios. Në qoftë se shëndeti dhe siguria e personelit dhe nxënësve përbëjnë shqetësim, Drejtorja Arsimore do ta konsiderojë mbylljen e shkollave dhe të ambienteve të punës.

A do të zhvillohen aktivitetet si zakonisht gjatë epidemisë?

Drejtorja Arsimore Peel do të vazhdojë të shërbejë regullisht dhe të veprojë si zakonisht, nëse një epidemi është shpallur jashtë Ontarios. Mbasi një epidemi është deklaruar brenda Ontarios, Drejtorja Arsimore do të aktivizojë planin e tij epidemiologjik të parapërgatitur. Si rezultat, shumë aktivitete do të vazhdojnë, por mund të zhvillohen në një mënyrë krejtësisht të ndryshme. Ndërsa shkollat janë të hapura gjatë një epidemie në Ontario, kërkesat e programit dhe niveli i shërbimeve, mund të mos realizohen.

Çfarë aktivitete do të vazhdonë gjatë një epidemie të deklaruar në Ontario?

Siç e përcaktuam dhe më lart, shumë aktivitete do të vazhdojnë, gjatë një epidemie të deklaruar në Ontario. Sidoqoftë, këto aktivitete mund të zhvillohen në mënyra krejtësisht të ndryshme, të cilat do të rezultojnë në mos aritjen e niveleve të dëshiruara. Ne shpresojmë të vazhdojmë aktivitetet e mëposhtme, për aq sa kohë to të na duket e përshtatshme:

- Mësimdhënien, vlerësimin dhe raportimin.
- Transportin e nxënësve – autobuzët do të vazhdojnë të mbajnë orarin e rregullt për aq kohë sa shkolla të jetë e hapur.
- Çerdhet – shërbimet do të mbeten të hapura, përderisa të mos jetë e rezikshme.
- Mësuesit zëvendësues – drejtuesit do të jenë në gjendje të sjellin mësuesë zëvendësues, që të sigurojnë nivelet e duhura të mbulimit me punë si the të kontrollit në shkollë.
- Vullnetarët – praktika e rregulltë për sa i përket shkollave të Peel, do të rishikohet rregullisht.
- Shërbime të kafeterive dhe programet e gatimit.
- Shërbime të mirëmbajtjes – duke përfshirë, por jo në mënyrë të pakufizuar, nxehjen, ajrin e kondicionuar, tubat e çesmave, rrymën elektrike dhe riparimin e kompjuterave.
- Mbledhjen e plehrave
- Ruajtjen e ndërtesave – në se shkolla është e mbyllur, do të programohet patrullim shtesë .
- Mbledhjet e Dretoriësë Arsimore – mund të mbahen më shpesh ose on-line
- Skuadra e ndërhyrjes në rast incidentesh kritike- do të veprojnë, por do të dërgohen jo në mënyrë të zakonshme
- Porositja e pajisjeve
- Posta e brendëshme dhe printimi

Cilat aktivitete do të ndërpriten, gjatë një epidemie të deklaruar në Ontario?

Me qëllim që të sigurojmë shërbimet më të nevojshme komuniteteve tona, aktivitetet e mëposhtme do të ndërpriten, gjatë një epidemie:

- Aktivitetet jashtë shkollore
- Programe ushqimore me bazë shkolle– të tilla si Ditët e Picave
- Udhëtimet jashtë shkolles/ekskursionet – të gjitha udhëtimet jashtë shkolles/ekskursionet do të anulohen, duke përfshirë dhe ato të planifikuarat dhe të paguara nga familjet.
- Mbledhjet e këshillit të shkolles – drejtori do të mbetet në kontakte të rregullta me kryetarin e këshillit të shkolles.
- Aktivitetet e zhvillimit profesional
- Mbledhjet e personelit – mbledhjet që i nxjerrin administratën ose personelin jashtë shkolles, do të anulohen ose mbahen me tele-konferencë.
- Lejet për qëndrim në shkollë jashtë orarit – lejet egzistuese dhe të reja, për përdorimin e strukturave të shkolles.
- Vazhdimi i arsimit – shkollat e natës, shkollat e verës dhe programet e gjuhëve të huaja
- Përdorimi i shkolles nga komunitetet – aktivitet jashtë shkollore/hyrje në shkollat e komuniteteve.
- Mësimi në shtëpi

Gjatë një epidemie të deklaruar në Ontario, si do t'i mbajë Drejtorja Arsimore Peel të informuar, komunitetin dhe punonjësit?

Drejtorja Arsimore Peel është e angazhuar që të sigurojë që të gjithë punonjësit, studentët, prindërit dhe anëtarët e tjerë të komunitetit të mbahen të informuar mbi planet e bordit. Bordi ka ndërtuar një plan të plotë komunikimi, për të siguruar që njerëzit të mbahen të informuar, para dhe gjatë një epidemie jashtë Ontario dhe kur është konfirmuar brenda në Ontario.

Gjatë deklarimit të një epidemie në Ontario, drejtorja arsimore do të sigurojë informacion të gjithanshëm dhe statusin e shkollave, nëpërmjet dy burimeve kryesore: Faqes së Internetit të Drejtorisë Arsimore Peel Bordit – www.peelschools.org – dhe linjaës telefonike të epidemisë.

Ne do të përpiqemi të punojmë në muajt e ardhshëm në planin e parapregatitor për epideminë, dhe do të vazhdojmë ti ndajmë informacionet e reja me ju.